



Njoftim per mediat date 25.03.2024. Zgjedhja e zevendeskrjetarit te GJKKO-se

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Më datë **24.03.2021** rezulton se znj.Irena Gjoka është zgjedhur si Zëvendëskryetare e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Sipas akteve ligjore dhe nënligjore mandati i Zëvendëskryetarit është tre vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme. Prandaj, znj.Irena Gjoka i mbaroi mandati më datë **24.03.2024**.

2. Për këto arsye, Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar zhvilloi sot më datë 25.03.2024 procedurën për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të kësaj Gjykate. Në këtë mbledhje ishte i pranishëm edhe Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor z.Ilir Rusi.

3. Referuar kërkesave të nenit 26, pika 3 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në R.SH.” si dhe të vendimit Nr. 7, datë 21.12.2018 “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që parashikojnë zgjedhjen e zëvendëskryetarit nga rradhët e gjyqtarëve të Gjykatës, pas procesit të verifikimit të përmbushjes së kriterëve ligjore për dy kandidaturat e paraqitura, konkretisht gjyqtarët **Erjon Bani dhe Erjon Çela**, në prani të nëntë gjyqtarëve, Mbledhja e Përgjithshme vijoi me kryerjen e procedurës së votimit.

4. Në përfundim, Z. Erjon Bani, rezultoi i zgjedhur me 6 vota, si Zëvendëskryetari i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

5. Në kushtet kur pozicioni i kryetarit është vakant, **Z. Erjon Bani** do të ushtrojë kompetencat e Kryetarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, deri në zgjedhjen e kryetarit të kësaj gjykate nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Tiranë, më datë 25.03.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

**Informacioni i mësipërm është aksesuar në faqen zyrtare të GJKKO në linkun:*

[https://www.gjp.gov.al/Gjykata_e_Posacme/Njoftime/Njoftime_per_shtyp/Njoftim_per_mediat_d
ate_25_03_2024_Zgjedhja_e_zevendeskryetarit_te_GJKKO-se.html](https://www.gjp.gov.al/Gjykata_e_Posacme/Njoftime/Njoftime_per_shtyp/Njoftim_per_mediat_d
ate_25_03_2024_Zgjedhja_e_zevendeskryetarit_te_GJKKO-se.html)